



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 19, datë 09 .04. 2013

**PËR**

**“MIRATIMIN E DETYRIMEVE FINANCIARE QË RRJEDHIN NGA GRANTI I OFRUAR BASHKISË SË TIRANËS NGA SHTETI I KATARIT PËR FINANCIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT “ZGJATIMI I BULEVARDIT VERIOR DHE REHABILITIMIN E LUMIT TË TIRANËS” (FAZA E PARË)”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 10, pika 3/I, shkronja “c”, nenit 15, pikat 1, 2 dhe 3, nenit 16, nenit 19, nenit 32, shkronja “dh” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 3, pika 19, nenit 10, shkronja b/ii, nenit 15 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); ligji nr.7776 datë 22.12.1993 “Për buxhetin lokal” (i ndryshuar); vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 53, datë 24.12.2012 për “Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2013-2015 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2013” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë detyrimet financiare që rrjedhin nga granti i ofruar Bashkisë së Tiranës nga Shteti i Katarit për financimin e zbatimit të Projektit “Zgjatimi i Bulevardit verior dhe Rehabilitimin e Lumit të Tiranës” (Faza e Parë)”, si më poshtë:

- Vlera e grantit	7.000.000 Euro
- Detyrimet financiare	200.000.000 lekë
2. Efektet financiare që rrjedhin nga granti i ofruar Bashkisë së Tiranës, për periudhën në vazhdim do të jenë të ndara sipas afatit të vlefshmërisë së grantit të ofruar.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Investimeve të Huaja, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Njësia e Menaxhimit të Projekteve, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**Niazi KOSOVRASTI**